



Pranuar / Dorezuar Prilijeno/Prodato Received/Delivery	15.05.2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKOMISHAK	4225/2023		1/6



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.521/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.521/2023 të datës 17.03.2023, të parashtruar nga ankuesi _____, kundër Vendimit me numër protokolli 130-02 të datës 15.02.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, në çështjen juridike “masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur më datë 15.05.2023, njëzëri mori këtë:

V E N D I M

- I. *Aprovohet si e bazuar* ankesa me numër A.nr.521/2023 e datës 17.03.2023, e parashtruar nga ankuesi _____
- II. *Shfuqizohet* Vendimi me numër protokolli 130-02 i datës 15.02.2023 i Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe *çështja kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të organi i njëjtë*.
- III. *Obligohet* Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, që brenda afatit prej pesëmbëdhjetë (15) ditësh nga dita e pranimit të vendimit, të ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij vendimi ashtu siç është përcaktuar në pikën II të dispozitivit.
- IV. Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës duhet të njoftohet me shkrim pas ndërmarrjes së veprimeve në pajtim me këtë vendim.

A r s y e t i m

1 / 6

Ankuesi (me tej ankuesi) i punësuar në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, më datë 17.03.2023 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit me numër protokolli 130-02 të datës 15.02.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, me pretendimin së se Komisioni Disiplinor në mënyrë të padrejtë dhe pa konstatim të gjendjes faktike ka bërë shqiptimin e masës disiplinore dhe së i njëjti ka shkelur procedurat ligjore në fuqi.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës (tutje referuar vetëm Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosies së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 29.03.2023 ka proceduar kërkesën për përgjigje në ankesë të Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, ndërsa kjo e fundit më datë 31.03.2023 ka përcjell shkresat lidhur me çështjen në procedurë të shqyrtimit dhe vendosjes.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil bazuar në dispozitat e nenit 17 paragrafi 2 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me Vendimin me numër protokolli 3802/2023 të datës 25.04.2023, ka vazhduar afatin për vendimmarrje lidhur me ankesën A.nr.521/2023 të datës 17.03.2023 edhe për dhjetë (10) ditë pune.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosien e Ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 2749/2023 të datës 17.03.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 31.01.2023 nga [] për ankuesin; Emailin e datës 30.01.2023 nga [] për [] Emailin e datës 27.01.2023 nga [] për [] Vendimin me numër protokolli 130-02 të datës 15.02.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; Ndryshimin dhe Plotësimi i Aktit të Emërimit i datës 01.10.2019; Kërkesën për zhvillimin e procedurave të prokurimit e datës 15.04.2022, 17.01.2022, 22.04.2022 nga ankuesi për Udhëheqësin e Divizionit të Prokurimit; Kërkesë për Zotimin e mjeteve e datës 04.03.2019 nga ankuesi; Emailin e datës 12.10.2022 nga [] për [] Emailin e datës 10.10.2022 nga [] për [] dhe []; Emailin e datës 02.03.2023 nga [] për ankuesin; Emailin e datës 02.03.2022, 04.07.2022 nga ankuesi për [] Kërkesë për zhvillimin e procedurave të prokurimit e datës 04.07.2022 nga ankuesi për Udhëheqësin e Divizionit të Prokurimit; Emailin e datës 07.10.2022, 04.10.2022, 28.09.2022 nga ankuesi për [], Emailin e datës 07.10.2022, 28.09.2022, 26.09.2022 nga [] për ankuesin; Emailin e datës 02.02.2022, 17.01.2022 nga ankuesi për [] Kërkesë për zhvillimin e procedurave të prokurimit e datës 04.10.2022 nga ankuesi për Udhëheqësin e Divizionit të Prokurimit; Emailin e datës 16.08.2022, 05.08.2022, 17.06.2022 nga [] për [] Emailin e datës 08.08.2022, 27.06.2022 nga [] për []; Emailin e datës 13.06.2022 nga [] për [] dhe []; Emailin e datës 09.06.2022 nga [] për []; Emailin e datës 06.06.2022 nga [] për [] dhe []; Emailin e datës 06.06.2022 nga [] për [] Emailin e datës 09.09.2022 nga Z.D për N.B; Emailin e datës 08.09.2022 nga [] për [] Emailin e datës 08.09.2022 nga [] për []; Emailin e datës 05.09.2022 nga [] për []; Emailin e datës 28.09.2022 nga ankuesi për [] Kërkesë për zhvillimin e procedurave të prokurimit e datës 26.09.2022, 17.01.2022, 02.03.2022, 31.10.2022 nga ankuesi për Udhëheqësin e Divizionit të Prokurimit; Kërkesën për përgjigje në ankesë me numër protokolli 3100/2023 e datës 29.03.2023; Përgjigjen në ankesë me numër protokolli 3173/2023 e datës

31.03.2023; Kërkesën për Komisionin Disiplinor e datës 20.01.2023 nga N.B; Procesverbalin e seancës së Komisionit Disiplinor i datës 31.01.2023, 27.01.2023, 13.02.2023; Emailin e datës 27.01.2023 nga për ; mailin e datës 08.02.2023 nga për ; Emailin e datës 16.11.2022, 11.10.2022 nga për ankuesin; Emailin e datës 04.01.2023 nga ankuesi për S.B; Emailin e datës 23.08.2022 nga N.B për ankuesin; Emailin e datës 22.08.2022 nga ankuesi për N.B; Emailin e datës 19.12.2022 nga R.LI për Z.D dhe ankuesin; Emailin e datës 07.12.2022 nga R.LI për EİNTECH SHPK; Pëlqim me Nr. 01-462-64828 e datës 19.12.2022; Emailin e datës 13.10.2022 nga N.B për ankuesin; Raport mbi gjendjen faktike të ujëmatësve në Parkun e Biznesit në Korretic të Epërme të Drenasit e datës 24.08.2022 nga Kompania Rajonalët e Ujësjellësit SH.A, Prishtina; Emailin e datës 15.08.2022 nga N.B për ankuesin; Emailin e datës 23.08.2022 nga N.B për ankuesin; Emailin e datës 23.08.2022 nga ankuesi për N.B; Emailin e datës 17.08.2022 nga Z.R; Emailin e datës 19.07.2022 nga N.B për ankuesin; Emailin e datës 19.07.2022 nga N.B për A.V; Emailin e datës 01.07.2022 nga F.B për ankuesin; Emailin e datës 14.07.2022, 01.07.2022 nga N.B për ankuesin; Emailin e datës 28.06.2022 nga ankuesi për N.B; Emailin e datës 01.03.2022 nga ankuesi për N.B; Emailin e datës 01.03.2022 nga F.D; Emailin e datës 30.08.2022 nga N.B për ankuesin; Emailin e datës 30.08.2022 nga SIMBNJ për N.B; Emailin e datës 16.11.2022 nga N.B për ankuesin; Pëlqim m Nr. 2339 i datës 02.07.2010; Emailin e datës 29.09.2022 nga ankuesi për N.B; Emailin e datës 28.09.2022, 26.09.2022 nga R.H për A.V; Emailin e datës 28.09.2022, 16.09.2022 nga A.V për R.H; Emailin e datës 02.09.2022 nga ankuesi për G.B; Emailin e datës 21.06.2022 nga M.B për ankuesin; Emailin e datës 21.06.2022 nga ankuesi për M.B; Memorandum Bashkëpunimi mes Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë dhe Kompanisë së Ujësjellësit Rajonal Prishtina e datës 15.04.2019; Autorizim pa numër dhe datë; Aneks Memorandum i Bashkëpunimit pa nënshkrim dhe datë; Emailin e datës 22.07.2022 nga ankuesi për N.B; Emailin e datës 12.07.2022 nga N.B për Z.D dhe ankuesin; Emailin e datës 15.06.2022 nga N.B për ankuesin; Raporti javor i punës 25 i datës 24.06.2022; Emaili i datës 20.06.2022 nga N.B për ankuesin; Emaili i datës 26.04.2021 nga N.B për ankuesin; Emaili i datës 26.04.2021 nga ankuesi për N.B; Emailin e datës 02.09.2022 nga N.B për ankuesin; Vendimin me Nr. prot: 5236 i datës 15.07.2021; Emailin e datës 15.02.2022 nga A.D për V.R-V; Emailin e datës 15.02.2022, 14.02.2022 nga Z.D për ankuesin; Vendimin me numër protokollit 3802/2023 i datës 25.04.2023 i Kryetarit të Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shëmimin Civil të Kosovës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës, konstatoi që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, *sepse:*

Nga administrimi i provave materiale rrjedh se ankuesi është i punësuar në Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë dhe se i njëjti sipas Aktit të Emërimit të datës 01.10.2019 ushtron pozitën e punës *Udhëheqës i Sektorit për Zhvillimin e Zonave Ekonomike.*

Me tej nga shkresat e lëndës rezultoi se më datë 20.01.2023, Drejtori i Drejtoratit për Zhvillimin e Sektorit Privat në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejtë të ankuesit, ka parashtruar kërkesë për inicim të procedurës disiplinore ndaj ankuesit me pretendimin se i njëjti gjatë vitit 2022 nuk ka përmbushur detyrat e punës lidhur me vendin e tij të punës respektivisht sektorin që udhëheq dhe se nuk janë respektuar afatet për përmbushjen e detyrave të punës.

Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë më Vendimin me numër protokolli 130-02 të datës 15.02.2023, ka shpallur përgjegjës ankuesin për shkelje të rëndë disiplinore sipas nenit 46 paragrafi 3 pika 3. 1 të Ligjit Nr.06/L114 për Zyrtarët Publikë duke shqiptuar masën disiplinore "ndalim në pagë për 20% në periudhën prej një (1) muaji".

Ankuesi brenda fatit ligjor parashtron ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, duke kundërshtuar Vendimin me numër protokolli 130-02 të datës 15.02.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, mbi bazën e pretendimeve së Komisioni Disiplinor në mënyrë të padrejtë dhe pa konstatim të gjendjes faktike ka bërë shqiptimin e masës disiplinore dhe së i njëjti ka shkelur procedurat ligjore në fuqi.

Lidhur me shqyrtimin e pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë referuar procedurës disiplinore, përkatësisht nenin 45 më të cilin përcaktohet se: "Përgjegjësia disiplinore është moszbatimi apo zbatim jo i duhur i detyrave të punës dhe detyrimeve të tjera ligjore, që përmban elementet si në vijim: 1.1. "ekzistimin e veprimit të paligjshëm apo mosveprimit;" 1.2. kryerjen e veprimit me faj apo mosveprimit; 1.3. ndodhja e pasojës 1.4. ndodhja e dëmit; dhe 1.5. lidhjen shkakësore dergjët veprimit të kryer dhe pasojës/dëmit", dhe si rrjedhojë ka konstatuar së nëpunësi civil mbanë përgjegjësi disiplinore në rastet kur vërtetohet se i njëjti më me veprimet ose mosveprimet e tij ka shkelur dispozitat e ligjit në fuqi ndërlidhur me detyrat funksionale dhe përgjegjësit e punës për pozitën që mbanë, dhe mbi bazën që të jenë plotësuar në mënyrë komulative elementet e përgjegjësisë disiplinore, rrjedhimisht edhe organ kompetent në realizimin e autoritetit publik gjegjësisht me rastin e vendosjes lidhur me të drejtat, detyrimet dhe interesat juridike të nëpunësve civil janë të obliguar që të veprojnë në pajtueshmëri me parimet e ligjshmërisë, proporcionalitetit, barazisë dhe mosdiskriminimit, objektivitetit dhe paanësisë, pritshmërisë së ligjshëm dhe të arsyeshme, si dhe informimit dhe ndihmës aktive siç është përcaktuar me nenin 4, 5, 6, 7, 9, 10, dhe 11 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Kolegji i Këshillit duke u bazuar në kuadrin ligjor si me sipër, e në kuptim të ligjshmërisë ka analizuar vendimin e kundërshtuar më ankesë dhe si rrjedhojë ka konstatuar së arsyetimi i Vendimit me numër protokolli 130-02 të datës 15.02.2023 të Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë është në kundërthënie me vetveten si dhe me vet dispozitvin, përkatësisht Komisioni Disiplinor në arsyetimin e vendimit të atakuar ka dhënë konstatime kundërthëniesve njëra me tjetrën ku citojmë : "ankuesi në seancën dëgjimore të datës 31.01.2023, gjatë deklaramit ka pretenduar t'i mohon faktet dhe dëshmitë e paraqitura nga udhëheqësi i tij. Por nga ajo që u deklarua dhe prezantua nga ana e tij, rezulton se ishte kundërthënëse për pika e lartcekura dhe në ndërkohë nuk ka arritur t'i mbështesë me prova dhe fakte konkrete, po ashtu z. drejtor i DZHSP, në cilësi të mbikëqyrësit të drejtpërdrejt të z. gjatë deklaratave të tij në seancën dëgjimore të datës 31.01.2023 nuk ka arritur ti dëshmoj dhe ti mbroj me argumente dhe dëshmi faktike, pretendimet kundër z, të cilat i ka renditur në iniciimin e fletëparaqitjes disiplinore. Si komision keni vlerësuar së ka dështuar mbikëqyrja e drejtpërdrejt në drejtim të z. lidhur me menaxhimin e aktiviteteve të parapara në objektiva të planit të punës në Dzhsp.

Rrjedhimisht, nga vlerësimi i provave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë Kolegji i Këshillit vlerëson së Komisioni Disiplinor në vendimin e goditur me ankesë ka dhënë vetëm konstatime të përgjithshme, pa specifikuar se cilat kanë qenë faktet relevante për vendimmarrje dhe shpalljen përgjegjës të ankuesit lidhur me shkeljet disiplinore të ngarkuara sipas vendimit të kontestuar. Përkatësisht në vlerësimin e Kolegjit Vendimi me numër protokolli 130-02 i datës 15.02.2023, mbështet vetëm në citate të deklaratave të personave të dëgjuar gjatë procedurës disiplinore, pa konstatim të bazës ligjore të vendimit dhe arsyeve pse është e zbatueshme në rastin konkret, kështu që mbi bazën e këtyre fakteve Kolegji konstaton se vendimi i goditur me ankesë është nxjerrë në kundërshtim me nenin 48 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i cili përcakton se: *"1. Arsytimi i siguron palës mundësinë që ta kuptojë aktin administrativ. Arsytimi përmban: 1.1. paraqitje të shkurtër të kërkesës së palës; 1.2. shpjegimin e situatës faktike mbi të cilën është marrë vendimi; 1.3. shkaqet të cilat kanë qenë vendimtare gjatë vlerësimit të provave; 1.4. bazën ligjore të vendimit dhe arsyeve pse është e zbatueshme në rastin konkret; 1.5. shkaqet për të cilat nuk është pranuar ndonjëri nga pretendimet e palëve; 1.6. në rastin e ushtrimit të diskrecionit, shpjegimin pse është ushtruar ai në mënyrën e dhënë në vendim 2. Një arsyetim që është dukshëm i pamjaftueshëm, i paqartë, kundërthënës apo i pakuptueshëm, është i barabartë me mungesën e ti"*.

Kolegji i Këshillit po ashtu ka gjetur së kërkesa për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit ishte bërë mbi bazën e pretendimeve për mos përmbushje të detyrave të punës si dhe mos respektim të afateve në përmbushje të detyrave të punës, ndërsa nga analizimi i vendimit të kundërshtuar rezulton së Komisioni Disiplinor nuk ka arritur që të vërtetojë se cilat detyra nuk janë përmbushur nga ankuesi dhe cilat janë afatet që ankuesi ka dështuar në përmbushjen dhe realizimin e detyrave dhe funksioneve të tij të punës, andaj, mbi bazën e ekzistimit të këtyre rrethanave rrjedhë detyrimi i Komisionit Disiplinor që në rishqyrtim të kësaj çështje të shqyrtoj dhe të vendos për çdo pretendim veç e veç të kërkesës për iniciim të procedurës disiplinore të datës 20.01.2023.


Duke qenë së vendimi i kontestuar me ankesë përmban të meta të tillë të cilat pamundësojnë vendosjen meritorë lidhur me këtë çështje juridiko administrative, Kolegji i Këshillit vlerëson që lënda të kthehet në rishqyrtim dhe rivendosje të Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë Kosovës, me detyrimin që i njëjti në ri procedurë të eliminojë shkeljet e konstatuara sipas këtij vendimi dhe të nxjerr vendim në pajtim me legjislacionin në fuqi dhe në mbështetje të fakteve të vërtetuara në mënyrë të plotë dhe drejtë.

Theksuar si me sipër, Kolegji duke vepruar sipas të nenit 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.2 dhe 1.6 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Këshillë juridike: *Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit. Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.521/2023

Avdyl BEKTESHI


Procesmbajtës

Ardita Haxhnikaj-DEMI


Kryetare e Kolegjit



Vendimi i dorëzohet:

- Ankuesit
- Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë;
- Udhëheqësit të Njesisë së Burimeve Njerëzore të Ministrisë së Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë; dhe
- Arkivit të KPMSHCK- së.